

Universiteti Barleti
Nr. prot. 771 Tiranë 21.07.2023

Qendra EKUILIBRIUM
Nr. prot. _____ Tiranë _____.____.2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET:**

UNIVERSITETIT BARLETI
(Universitet Aplikativ dhe Sipërmarrës)

dhe

Qendra EQUILIBRIUM

duke mbajtur parasysh se:

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të programeve të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si pjesë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve nënshkruese, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të këtij



neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkët, si dhe çdo detyrim financiar midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:

- a. **Fuqizimi i sektorit dhe profesionistëve** në përputhje me standardet, normat dhe direktivat e BE si dhe përmirësime ligjore për mbështetjen dhe mirëfunksionimin e profesionit nëpërmjet përafrimit me nismat dhe iniciativat europiane dhe lobimit për fuqizimin e sektorit dhe profesionit, bashkëpunimeve, rrjetëzimeve dhe partneriteteve për promovim të dyanshëm;
- b. **Zhvillimit e burimeve njerëzore** përmes edukimit dhe aftësisht drejt kërkesave të tregut të punës e sektorit nëpërmjet bashkëpunimit të stafit akademik dhe specialistëve të të dy institucioneve, praktikave e punësimit të mundshëm të diplomuarëve, trajnimeve, apo çertifikatave të fushës;
- c. **Kërkimit të Aplikuar dhe novacionit nëpërmjet** eventeve dhe aktivitete për të promovuar dhe shkëmbyer eksperiencat, organizimit të seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme, konsulencave reciproke, studimeve, etj.
- d. **Ngritjen dhe realizimin e projekteve dhe programeve nga fonde dhe donatorë të ndryshëm;**

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 2 vjet nga data e nënshkrimit.

2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje do të konsiderohet e rinovuar.

Neni 3

Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim Barleti) është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkurruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në



2. praktikat e vlerat më të mira ndërkombëtare, më programe shumë-disiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

3. *Qendra EQUILIBRIUM* u themelua në vitin 02/12/2020, me një staf me përvojë mbi 10 vjeçare me fëmijë me patologji të ndryshme në fushën e zhvillimit si dhe vlerësim apo ndërtim programesh për fëmijët dhe individë të tjerë të cilët merren me këta fëmijë për të plotësuar të gjitha shërbimet e nevojshme.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti Barleti:*

- a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve për trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- b. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
- c. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut *Qendra EQUILIBRIUM*, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
- d. Shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për përmbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet më të mira në nivel evropian;
- e. Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj. Ardiola Bodinaku.

2. *Qendra EQUILIBRIUM:*

- a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;
- b. Angazhohet në ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë në përputhje me strategjitë e brendshme të zhvillimit të subjektit;
- c. Angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;



- d. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - e. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Barleti, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm;
 - f. Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj Vitjona Begeja
3. *Palët bashkërisht bien dakord si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
 - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese, të shprehur në një dokument të shkruar;
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, sjell si pasojë prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi;
3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) Qendra EQUILIBRIUM

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti "Barleti"

Qendra EQUILIBRIUM

Rektor

Administrator


Prof. Dr. Suzana Guxholli (firma, vula)


Z. Arber Begeja, firma vula

